



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.Dh.Shk.II.nr.112/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbare të kreditorit Hotel Carshia e Jupave, N.H.T.SH. “Shkelqimi - 2” SH.P.K., rr.“Ismajl Qemajli” në Gjakovë, të cilin e përfaqëson G.P. avokat nga Gjakova, kundër debitorit Komuna e Gjakovës, të cilën me autorizim e përfaqëson V.SH. me bazë juridike, përmbare pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.154/2020 të datës 23.07.2021, me datë 23.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e debitorit Komuna e Gjakovës, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.154/2020 i datës 23.07.2021, sa i përket pikës II të dispozitivit, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: PRANOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Gjakovës, SHFUQIZOHET (vihet jashtë fuqie) pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.601/2018 i datës 30.11.2018, për shumën prej 515.50 Euro, ashtu që propozimi për përmbare i kreditorit, për këtë shumë të borxhit REFUZOHET I PABAZUAR, ndërsa REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Gjakovës, MBETET në fuqi pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.601/2018 i datës 30.11.2018, për sa i përket shumës prej 2,802.00 Euro.

II. Mbetet e pashqyrtuar pika I dhe III e dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.154/2020 i datës 23.07.2021.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.154/2020 të datës 23.07.2021, në pikën I. të dispozitivit ka Aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Gjakovës dhe Urdhrin për përmbare të përmbaruesit privat Gëzim Gjoshi me seli në Gjakovë P.nr.601/2018 të datës 30.11.2018, e ka Anuluar për shumën e përgjithshme të borxhit prej 18,607.50 Euro. Në pikën II të dispozitivit ka

Lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin të përmbaresit privat Gëzim Gjoshi me seli në Gjakovë P.nr.601/2018 të datës 30.11.2018 me të cilin është caktuar përmbaresi për shumën e përgjithshme të borxhit prej 3,317.50 Euro, me kamat përkatëse ligjore duke filluar nga dita e pranimit të urdhrin e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbaresore sipas suksesit në procedurë. Në pikën III të dispozitivit ankesa kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbaresore, për pjesën e urdhrin të mbetur në fuqi.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar debitori për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa në tërësi, të prishet aktvendimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaresore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Hotel Carshia e Jupave, N.H.T.SH. "Shkelqimi - 2" SH.P.K., rr."Ismajl Qemajli" në Gjakovë, me datë 30.11.2018 ka paraqitur propozim për përmbares, kundër debitorit Komuna e Gjakovës, në bazë të dokumentit të besueshëm faturave, për shumën e përgjithshme të detyrimit në vlerë prej 21,925.00 Euro, ndërsa me datë 21.04.2021 kreditori ka bërë precizimin e kërkesës duke theksuar se nga borxhi i përgjithshëm prej 21,925.00 Euro nga debitori është paguar shuma prej 7,307.50 Euro, ndërsa ka mbetur pa paguar shuma prej 14,617.50 euro.

Përmbaresi privat Gëzim Gjoshi, duke vepruar sipas propozimit për përmbares të kreditorit me urdhrin P.nr.601/2018 të datës 30.11.2018, ka lejuar përmbaresimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm - fatura i plotëson kushtet për përmbares.

Kundër këtij urdhri përmbaresor debitori me datë 07.12.2018, ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbaresor, me arsyetim se faturat në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbares nuk paraqesin dokument të besueshëm konform dispozitave të LPP-së, se borxhi i kërkuar është parashkruar dhe të njëjtat fatura nuk janë pranuar nga debitori, se me kreditorin nuk ka pasur marrëdhënie kontraktuale. Tutje ka deklaruar se debitorit i mungon legjitimiteti real pasiv, andaj ka propozuar që të aprovohet prapësimi dhe të anulohet urdhri për përmbares P.nr.601/2018 i datës 30.11.2018.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur i autorizuari i kreditorit me datë 11.12.2018, duke theksuar se prapësimi i paraqitur nga debitori është i pabazuar, se faturat në bazë të së cilave është

paraqitur propozim për përmbarim janë në origjinal, janë pranuar nga debitori me datë 17.08.20218, që nënkupton se në rastin konkret kemi ndërprerje të parashkrimit, andaj ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar.

Gjykata Themelore në Gjakovë, duke vepruar sipas prapësimi të debitorit ka nxjerr aktvendimin PPP.nr.198/2018 të datës 21.02.2019, me të cilin ka aprovuar në tërësi prapësimin e debitorit si të bazuar dhe ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.601/2018 të datës 30.11.2018. Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur kreditori, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës së palës ankuese, me aktvendimin Ac.nr.1178/2019 të datës 16.07.2020, ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit dhe ka anuluar aktvendimin PPP.nr.198/2018 të datës 21.02.2019 dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, me arsyetimin që në riprocedurë të vlerësohet se a janë pranuar faturat nga debitori, cilat fatura janë nënshkruar dhe cilat nuk janë nënshkruar, a ka realizuar debitori ndonjë pagesë si dhe të vlerësohet prova e dorëzuar nga kreditori lidhur me pranimin e faturave.

Në procedurën e rishqyrtimit, Gjykata Themelore në Gjakovë pas vlerësimit të provave të administruara ka marr aktvendimin PPP.nr.154/2020 të datës 23.07.2021, me të cilin në pikën I. të dispozitivit ka Aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Gjakovës dhe urdhrin për përmbarim të përmbaruesit privat Gëzim Gjoshi me seli në Gjakovë P.nr.601/2018 të datës 30.11.2018, e ka anuluar për shumën e përgjithshme të borxhit prej 18,607.50 Euro. Në pikën II të dispozitivit ka Lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin të përmbaruesit privat Gëzim Gjoshi me seli në Gjakovë P.nr.601/2018 të datës 30.11.2018 me të cilin është caktuar përmbarimi për shumën e përgjithshme të borxhit prej 3,317.50 Euro, me kamat përkatëse ligjore duke filluar nga dita e pranimin të urdhrin e deri në pagesën definitivë si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore sipas suksesit në procedurë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në ri procedurë pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe duke ka marr për bazë sugjerimet e Gjykatës së Apelit ka gjetur se faturat në bazë të se cilave është paraqitur propozimi për përmbarim të precizuara me parashtresën e datës 21.04.2021 nga kreditori, paraqesin dokument të besueshëm dhe të njëjta i plotësojnë kushtet e kërkuar me dispozitën e nenit 29 paragrafi 1.3 dhe 3, me nenin 38 paragrafi 2 dhe nenin 40 paragrafi 1, pika 1.3 të LPP-së. Tutje ka theksuar se borxhi i kreditorit për faturat nga data 23.05.2007 deri me datë 18.10.2015 në shumë prej 11,663.50 Euro është parashkruar duke u bazuar në dispozitën e nenit 355 të LMD-së. Ndërsa sa i përket shumës së borxhit prej 7,307.50 Euro gjykata e ka anuluar urdhrin për shkak të përmbushjes së pjesërishtme të borxhit nga debitori. Gjykata ka anuluar urdhrin përmbarimor për shumën prej 18,971.00 Euro si në pikën I të dispozitivit. Tutje gjykata ka theksuar se pjesa e borxhit sipas faturave nr.4440, 4448, 4465, 4473, 4521, 4522, 4568, 4584, 4933 dhe 5101 për shumën e përgjithshme prej 3,317.50 Euro, ka mbetur në fuqi, pasi që për këtë pjesë të borxhit nuk ka arritur afati i parashkrimit të kërkesës, andaj ka vendosur sikur në pikën II të dispozitivit.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë nuk

mund ta pranojë si të rregullt dhe të ligjshëm, për shkak se kjo gjykatë përkundër konstatimit të bërë se aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të LPK-së, për të cilat gjykata e ankimit kujdeset sipas detyrës zyrtare, kjo gjykatë me analizimin dhe vlerësimin ndryshe të shkresave të lëndës, ka konstatuar një gjendje tjetër faktike nga ajo e cila është konstatuar nga gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si në pikën II të aktvendimit të ankimuar, mbi bazën e të cilës gjendje faktike të vërtetuar kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret ka kushte që aktvendimi i ankimuar në pikën II të dispozitivit të ndryshohet. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë duke mos vlerësuar në mënyrë të drejtë provat nga shkresat e lëndës, gabimisht është referuar dhe ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit të Procedurës Përmbartimore dhe Kontestimore, ku si pasojë ka pasur edhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, për të cilën shkelje gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në mbështetje të nenit 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se në rastin konkret debitori bazuar në faturat nr.4440, nr.4448, nr.4465, nr.4473, nr.4521, nr.4522, nr.4568, nr.4584, nr.4933 dhe nr.5101 ka për detyrim ndaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 3,317.50 Euro, kjo për faktin se me vlerësimin e shkresave të lëndës konstatohet se debitori ka paguar faturën nr.4933 të datës 27.05.2017, e kjo vërtetohet në bazë të pagesës së datës 23.10.2020 në shumë prej 515.50 Euro. Pra kjo gjykatë sipas provave shkresore, gjen se debitori gjendet në detyrim ndaj kreditorit vetëm për shumën prej 2,802.00 Euro dhe kjo për faturat nr.4440, nr.4448, nr.4465, nr.4473, nr.4521, nr.4522, nr.4568, nr.4584 dhe nr.5101, kështu që për këtë pjesë të detyrimit refuzohet prapësimi i debitorit dhe mbetet në fuqi urdhri përmbartimor P.nr.601/2018 i datës 30.11.2018, pasi që për faturat e sipërcituara nuk ka prova se të njëjtat janë paguar nga debitori.

Dhomat e shkallës së dytë nuk e ka pranuar si të drejtë përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me mënyrën e vendosje si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit përkitazi me shumën e detyrimit të debitorit ndaj kreditorit, duke ndryshuar pikën II të dispozitivit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket obligimit në shumë prej 2,802.00 Euro, gjendje kjo e konstatuar sipas shkresave dhe provave të lëndës.

Gjykata ankimore ka gjetur se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me parashkrimin e borxhit sipas pikës II të dispozitivit të aktvendimit të ankimuar, kjo për faktin se borxhi për faturat nr.4440, nr.4448, nr.4465, nr.4473, nr.4521, nr.4522, nr.4568, nr.4584 dhe nr.5101, sipas propozimit të kreditorit kërkohet për periudhën që përfshin vitin 2016 dhe 2017, ndërsa kreditori propozimi për përmbartim e ka paraqitur me datë 30.11.2018, nga ku rezulton se në rastin konkret nuk kemi parashkrim të borxhit për faturat e lartcekura, për arsye se nuk ka kaluar afati tre vjeçar i parashkrimit, siç parashihet me dispozitën e nenit 355 të LMD-së.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar sa i përket pikës II të dispozitivit të ndryshohet, të aprovohet pjesërisht prapësimi i debitorit si i bazuar dhe urdhri për lejimin e përmbartimit pjesërisht të anulohet,

ndërsa për pjesën e anuluar procedura përmbartimore përfundon konform nenit 12 pika 4 e Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, që secila palë të bartë shpenzimet e saj të procedurës duke u bazuar në dispozitën e nenit 450 të LPK-së, pasi që e ka pasur parasysh suksesin e palëve në procedurën përmbartimore.

Gjykata ka vendosur sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që pika I e dispozitivit të aktvendimit të ankimuar, nuk kanë qenë objekt ankimit, andaj aktvendimi i ankimuar në këtë pjesë ka mbetur i pa shqyrtuar.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1, pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.sh.II.nr.112/2023 me datë 23.02.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha